




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 26.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 24.04.2023 të parashtruara nga: **Operatori Ekonomik: " Fadil Sinanaj " BI Adem Jashari, H32, K1, B3 Gjilan**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Shërbime të avokatisë dhe përfaqësimit ligjorë " me nr.të prokurimit 651-23-2642-2-2-1 dhe me nr.të brendshëm GI 651 23 22 221 nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohet si e jashtë afatshme-** kërkesa për ri-shqyrtim e **Operatori Ekonomik " Fadil Sinanaj " BI Adem Jashari, H32, K1, B3 Gjilan**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Shërbime të avokatisë dhe përfaqësimit ligjorë " me nr.të prokurimit 651-23-2642-2-2-1 dhe me nr.të brendshëm GI 651 23 22 221** e dt. 24.04.2023 kundër **B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të datës 19.04.2023 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
2. **AK - Komuna e Gjilanit vendos të vazhdojë sipas Njoftimit mbi Vendimin e AK për Kontratë të datës 19.04.2023.**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Fadil Sinanaj BI Adem Jashari, H32, K1, B3 Gjilan, me datë 24.04.2023 në ora 19:28 minuta, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Shërbime të avokatisë dhe përfaqësimit ligjorë " me nr.të prokurimit 651-23-2642-2-2-1 dhe me nr.të brendshëm GI 651 23 22 221.**

Autoriteti Kontraktues me datë 26.04.2023 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Gjilan – konfirmon se ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të dt. 24.04.2023 në ora 19:28h.

Ashtu, siç jeni edhe ju të informuar rreth kësaj procedure përmesë platformës elektronike e-prokurimi AK – me dt. 19.04.2023 ka bërë publikimin e B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES.

Sqarim:

Bazuar në Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave

Neni 3 Informatat e përgjithshme

3.1 Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, **pa pagese**, nga cilado palë e interesuar **në çdo fazë** të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me **çfarëdo aktiviteti ose lëshimi** të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij pranë **Autoritetit kontraktues i cili udhëheq aktivitetin e prokurimit**. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërliohen me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera**, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.

I. PARAQITJA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 4 Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues

4.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- c) **Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.**


Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Gjilan, refuzimin e kësaj kërkesë për rishqyrtim e bënë duke u bazuar në: Neni 7 Refuzimi i një kërkesë për shqyrtim - pasi që e njëjta nuk është dorëzuar brenda afateve kohore të përcaktuara në nenin 4 të këtyre rregullave.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Shqipe Hoxha


Zyrtare përgjegjëse e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.